



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Komisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Punës së Kuvendit
Mbledhja nr. 02
Data 05. 05. 2008

P R O C E S V E R B A L

Mbledhjen e kryesoi:
Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit

Të pranishëm në mbledhje ishin:
Kolë Berisha, Hydajet Hyseni, Fehmi Mujota, Ismet Beqiri, Besa Gaxherri.

Munguan: Džezair Murati, Ramadan Gashi, Fatmire Berisha, Suzana Novoberdaliu.

Nga zyra mbështetëse morën pjesë: Nur Çeku, Ibush Mujaj, Biljana Petrović, Antigona Ibraj.

Mbledhja filloi në orën 11:00 në sallën N-225, në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës, me këtë rend dite:

R e n d i i d i t ë s :

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 26.02.2008
3. Nisma për hartimin e Rregullores së Punës së Kuvendit
4. Të ndryshme

Pika e parë: Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

Pika e dytë: Procesverbali i mbledhjes së datës 26.02.2008, u miratua pa vërejtje.

Pika e tretë: Në lidhje me këtë pikë, kryetari i komisionit njoftoi të pranishmit se do të fillojnë punimet për hartimin e Rregullores së Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës. Ai propozoi, që të caktohet një grup punues, në mënyrë që të bëhet hartimi preliminar i Rregullores, në mënyrë që më pas të shqyrtohet në komision. Ai gjithashtu tha se do të ishte mirë, që të shkojmë diku ose jashtë Kosovës ose brenda, së paku tri ditë, në mënyrë që të punojmë sa më intensivisht.

Hydajet Hyseni, propozoi që grupet parlamentare ta caktojnë nga një anëtar, në mënyrë që ata ti sjellin vërejtjet e tyre, të cilat më pas do të duhej të shqyrtohen në komision. Ai gjithashtu tha se në këtë grup punues duhet të marrin pjesë edhe ekspert të ndryshëm, si p.sh, ekspert nga shoqata e juristëve, USAID, NDI, OSBE-ja etj.

Ismet Beqiri, tha se ky grup duhet të caktohet nga komisioni dhe jo nga grupet parlamentare, sepse hartimi i rregullores është detyrë e komisionit, por unë pajtohem që në këtë grup të ftohen edhe ekspert të tjerë ashtu siç e ceku edhe z.Hydajet Hyesni. Ai gjithashtu theksoi se do të ishte mirë që deri ka fundi i qershorit të miratohet kjo rregullore.

Fehmi Mujota, propozoi që ky grup të jetë i përbërë nga një anëtar prej secilës parti politike. I propozoi që ky grup punues të jetë i përbërë nga: Ahmet Isufi, Kolë Berisha, Besa Gaxherri, Hydajet Hyseni, Džezair Murati, dhe Suzana Novoberdaliu.

Anëtarët e komisionit u pajtuan me këtë përbërje të grupit punues, ata gjithashtu u pajtuan edhe që të ftohen ekspert të tjerë, që merren me këtë lami edhe jashtë Kuvendit.

Kryetari i komisionit në përmbyllje të këtij takimi tha, ju ftoj që ky grup punues të takohet edhe njëherë gjatë kësaj jave, sepse sa më shpejt që do të mund të miratohet kjo rregullore aq më mirë do të jetë.

Mbledhja përfundoi në orën 11:55

Ahmet Isufi
Kryetar i Komisionit për
Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Punës së Kuvendit